



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.800/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përmbarimore të kreditorit N.T.P. “Uka”, me NUI 810565939 dhe NRB 71091155, Mitrovicë, kundër debitorit “Oki” Sh.P.K, me NUI 810873720 dhe NRB 71351165, rr. “Imzot Nik Prelaj” nr. 8, Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.196/2020 të datës 16.12.2020, të Përmbaruesit Privat Ilmi Miftaraj, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 28.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Oki” Sh.P.K., ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbarimor P.nr.196/2020 i datës 16.12.2020, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj në shumën prej 8,500.00 EUR, dhe në këtë pjesë të përmbarimit procedura PËRFUNDOHET.
- II. REFUZOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit “Oki” Sh.P.K., ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbarimor P.nr.196/2020 i datës 16.12.2020, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, për borxhin në lartësi prej 16,535.08 EUR.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim, në çështjen përmbarimore të kreditorit N.T.P. “Uka”, ka lëshuar urdhrin përmbarimor, P.nr.196/2020 të datës 16.12.2020 me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave dhe atë: Faturës me nr.131/19 e datës 05.12.2019, Faturës me nr.16/20 e datës 28.02.2020 dhe Faturës me nr.50/20 e datës 02.07.2020, me të cilin ka obliguar debitorin që në

emër të borxhit të mbetur të papaguar me kamatë prej 8% në vit nga dita e ushtrimit të propozimit e deri në pagesën përfundimtare si edhe pagesën e shpenzimeve përmbarimore.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të mospërfilljes së marrëveshjes gojore që kanë pas me kreditorin. Shtoi se me kreditorin kanë pas marrëveshje gojore për mallin që e kanë paguar dhe pagesat të bëhen gradualisht deri në përfundim të Objekteve dhe jemi habitur që lënda ka shkuar te përmbaruesi pa qenë të lajmëruar paraprakisht nga kreditorit që do të ndërmerr një veprim të tillë. Po ashtu theksoi se nuk ekziston një obligim i tillë për arsye se kemi bërë pagesa në këto fatura dhe se janë të bashkëngjitura këtij prapësimi dhe atë: Dëshmia 1: fletëpagesa për faturën nr.131/19 në vlerë prej 3,500.00 euro dhe dëshmia e dytë, fletëpagesa për faturën nr.50/20 në vlerë prej 5,000.00 euro. Tutje shtoi se kanë mall që duhet kthyer sipas marrëveshjes gojore në vlerë prej 6,851,00 euro, andaj del se obligimi i paraqitur nga kreditori nuk është i saktë, por është 12,884.28 euro dhe përfundoi se nuk jemi që mos të paguajmë pjesën e mbetur të obligimit, por për pjesën e mbetur kërkojmë që të respektohet marrëveshja gojore që e kemi pas me kreditorin.

Kreditori nuk parashtroi përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata nga të lartcekurat gjeti se Fatura me nr.131/19 e datës 05.12.2019, Fatura me nr.16/20 e datës 28.02.2020 dhe Fatura me nr.50/20 e datës 02.07.2020, në bazë të së cilave është lejuar përmbartimi, përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përcaktuara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, koha e përmbushjes së detyrimit, si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, e po ashtu faturat janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt ky që vërtetohet përmes nënshkrimit dhe vulës së protokollit të debitorit si në faturë. Andaj, Gjykata, vlerëson se dokumenti mbi bazën e të cilit është mbështetur propozimi për përmbartim, dhe është lejuar përmbartimi paraqet bazë për lejimin e përmbartimit dhe të njëjtat kanë tipare të përmbartueshmërisë.

Gjykata, duke vlerësuar pretendimet e debitorit të ngritura në prapësim gjeti se një pjesë e borxhit që rrjedh nga faturat e lartcekura dhe atë Fatura me nr.131/19 dhe fatura me nr.50/20 janë përmbushur pjesërisht, dhe atë borxhi në vlerë prej 8,500.00, EUR nga shuma e përgjithshme e kërkuar nga kreditori prej 25,035.08 EUR, fakt ky që vërtetohet nga Urdhër-pagesa kombëtare e datës 18.08.2020, nga e cila evidentohet se debitori ka paguar pjesërisht faturën nr. 131/19, në shumën prej 3,500,00 EUR, dhe Urdhër-pagesa kombëtare e datës 03.11.2020, nga e cila evidentohet se debitori ka paguar pjesërisht faturën nr.50/20, në shumën prej 5,000.00 Euro.

Andaj, duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*, Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi duke aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit, për shkak se Urdhri Përmbartimor P.nr. 196/2020 i datës 16.12.2020 në shumën prej 8,500.00 EUR është bërë i pa efekt juridik për shkak të pagesës së borxhit. Ndërsa vendimin mbi përfundimin e procedurës përmbartimore në këtë pjesë të përmbartimit, Gjykata e mbështeti në nenin 66.4 të LPP-së i cili përcakton se *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore.*

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi, duke lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor P.nr. 196/2020 i datës 16.12.2020 në shumën prej 16,535.08 EUR pasi që për këtë pjesë të përmbartimit debitori nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur prapësimin e tij, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet në tërësi Urdhri për lejimin e përmbartimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Gjykata po ashtu i vlerësoi edhe pretendimet e debitorit lidhur me kthimin e mallit sipas marrëveshjeve verbale, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 64 par.4, nenin 71 dhe nenin 73 të LPP-së, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.800/22, datë 28.07.2023

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.